



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:030017

Datë: 15.08.2018

Numri i dokumentit: 00101953

P.nr.385/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, me Gjyqtaren Diana Sina dhe me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit P. Nd.nga fsh.... K.Gjakovë, për shkak të veprës posedimi i paautorizuar narkotikëve, substanca psikotrope ose analoge, nga neni 275 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore-Departamenti i Përgjithshëm, në Gjakovë, PP.nr.149/17, të dt.09.06.2017, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datën **15.08.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **P. N.**, i biri i M., i nënës L., e gjinisë G, data e lindjes ... në fsh..... K.Gjakovë, ku edhe tani banon, ka të kryer shkollën e mesme, puntor-kamariyer, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Është fajtor

Sepse: Me dt.12.11.2016 rreth orës 21.30 minuta, në fshatin ... K.Gjakovë, pas një kontrolli në dhomën e të akuzuarit nën jastëk si dhe në dollapin e tij afër shtratit, në kundërshtim me nenin 9 e 14 të Ligjit për barna narkotike, e duke ditur se ka të bëjë me substancë narkotike e duke mos poseduar leje nga organi kompetent, i është gjetur në posedim pa autorizim narkotiku i fshehur me substancë bimore, me ngjyrë të gjelbërt e cila pas ekzaminimit të AKF Prishtinë, sipas raportit datës 24.05.2017, ka rezultuar të jetë narkotik i llojit Kanabis (marihuan) në peshë neto prej 0,82 gr.e substanca është sekuestruar e gjendet në Stacionin policor në Gjakovë.

-me çka ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar narkotikëve, substanca psikotrope ose analoge, nga neni 275 par.2 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,7,17 par.1, 41, 73,85, 86 par. 1, 2 dhe 5 dhe nenit 275 par.2 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

VËRJETJE GJYQËSORE

Të akuzuarit P. N. i bëhet me dije se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme që përben vepër penale dhe nëse ai sërish kryen vepër të tillë, Gjykata do të ia shqiptoi sanksion më të rëndë penal.

Detyrohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30.- (tridhjetë)**Euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

I SHQIPTOHET – dënimi plotësues, konfiskohet substanca narkotike:qese plastike tejdukshme e mbushur me bari ngjyrë të gjelbër narkotik të lloit Kanabis (marihuan) në peshë neto prej 0,82 gram, sendet të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale, komfor nenit 275 par.3 të KPRK-ës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore- Departamenti i Përgjithshëm, në Gjakovë, ka ngritur aktakuzën PP.nr.149/2017, të dt. 09.06.2017, kundër të akuzuarit P. Nd.nga fsh.... K.Gjakovë, për shkak të veprës posedimi i paautorizuar narkotikëve, substanca psikotrope ose analoge, nga neni 275 par.1 të KPRK-së, dhe ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor, të dënohet sipas Ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.

Prokurori i shtetit Ismet Tofaj pasi lexoi aktakuzën bën përmisimin e kualifikimit juridik ashtu që në vend të paragrafit 1 duhet të jetë paragrafi 2, meqenëse sasia e substancës narkotike është më pak se 3 gram, si dhe kryesi i kësaj vepre për herë të parë ka kryer këtë vepër penale, si dhe konfiskimi i substancën narkotike të bëhet në vend të nenit 62 par.1 pika 2.7 neni 275 par.3,ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar.

I akuzuari P. Nd.në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë, deklaroi se e pranon fajësinë ashtu siç janë përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, substanca narkotike në peshë 0,82 gram e kam marr me qëllim që ta bëj cigare dhe të njëjtën ta konsumoi, kam deshtë që të bëjë këtë veprim nga kureshtja që të provoi substancën narkotike, por nuk jam konsumues i substancave narkotike dhe as që jam i varur prej tyre, atë ditë kur e njëjta më është konfiskuar nga ana e policisë, më asnjëherë nuk kam provuar që të njëjtën ta konsumoi, shton se jam në gjendje të dobët materiale, jam punëtor kamarier, kontribuo në familje si dhe për herë të parë paraqitem në gjykatë për një vepër të kryer penale dhe premtoi se do të jetë edhe hera e fundit, andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh këto rrethana me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet në faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari P. Nd.: Me dt.12.11.2016 rreth orës 21.30 minuta, në fshatin O. K.Gjakovë, pas një kontrolli në dhomën e të akuzuarit nën jastëk si dhe në dollapin e tij afër shtratit, në kundërshtim me nenin 9 e 14 të Ligjit për barna narkotike, e duke ditur se ka të bëjë me substancë narkotike e duke mos poseduar leje nga organi kompetent, i është gjetur në posedim pa autorizim narkotiku i fshehur me substancë bimore, me ngjyrë të

gjelbërt e cila pas ekzaminimit të AKF Prishtinë, sipas raportit datës 24.05.2017, ka rezultuar të jetë narkotik i llojit Kanabis (marihuan) në peshë neto prej 0,82 gram, e substanca është sekuestruar e gjendet në Stacionin policor në Gjakovë.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjyquese konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara të nenit 253 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të parapara nga neni 73 të KPRK-ës, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit, si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim, sjelljet e kryesit në të kaluarën se i akuzuari më parë nuk kanë qenë i dënuar, sjelljet e tij pas kryerjes së veprës, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese Gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, gjendjen e dobët ekonomike, është mbajtës i vetëm i familjes, si dhe pendimin e thellë të shprehur gjatë shqyrtimit gjyqësor. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin Gjykata ka ardh në përfundim se me shqiptimin e vërejtjes gjyqësore do të arrihet qëllimi i vërejtjes që të akuzuarin ti jepet qortim, e që në rastin konkret edhe vërejtja gjyqësore është sanksion i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e dënimit dhe qëllimin e vërejtjes gjyqësore nga neni 41 dhe 85 të KPRK-së, dhe se ky sanksion i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marr komfor nenit 450 par.2 nën par.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, komfor neneve 498 par.1 dhe 2 dhe 499 par.1,2,3 lidhur me nenin 365 të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i Përgjithshëm-
P.nr.385/17 dt.15.08.2018

Sekretarja Juridike
Lamije Kuqi

Gjyqtarja e vetme gjyquese
Diana Sina

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:030017
Datë: 15.08.2018
Numri i dokumentit: 00101953